



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:266084
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05516165

C-IV-14-3493

Ankuesi

Xh M, fshati M, Lipjan
Përfaqësuar nga E Z, avokate nga Prishtina.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 28 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN053-0174 datë 07 prill 2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankueses **Xh M** (për tani të ndjerin **A M**) në emër të kompensimit për paga të papaguara periudhën 2003 – 2006, t’i paguaj **shumën prej 1,446.00 €**, si dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 144.60 €**.
- 3.** Shumat e aprovuara si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 4. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankueses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **104.00 €**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 07 maj 2014, ankuesi (nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar Q Z avokat nga Prishtina) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN053-0174 datë 07 prill 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 2003 - 2006 në shumë 1,446.00 € nga NSH “MMI Goleshi” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ishte në marrëdhënie punë në kohë të pacaktuar tek e paditura dhe

se për shkak të privatizimit të të paditurës, ankuesi është njoftuar se i ndërprehet marrëdhënia e punës ndërsa pagat e papaguara mbeten përgjegjësi e të paditurës nga momenti i fillimit të likuidimit. Ankuesi më tej theksoi se e paditura duke vendosur në lidhje me kërkesën e tij sipas vendimit të kundërshtuar e ka refuzuar kërkesën në bazë të parashkrimit të kërkesës. Ankuesi më tej thekson se e konteston në tërësi vendimin e kundërshtuar si të pabazuar, sepse kërkesa ishte e lidhur me fillimin e procesit të likuidimit dhe në asnjë mënyrë nuk ishte kontestuar kërkesa e tij. Ankuesi i propozon gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'ia paguaj pagat e papaguara me kamatë ligjore prej 3.5% nga arritja e kërkesës e deri me pagesën e plotë të saj si dhe shpenzimet e procedurës e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pasi aktgjykimi të jetë i formës së prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij ka bashkangjitur në kopje dëshmitë si: Vendimin e kundërshtuar, Njoftimin e përfaqësuesit të autorizuar avokat Q Z drejtuar AKP-së datë 07 maj 2014, Autorizimin për përfaqësim ligjor avokat Q Z datë 26 shkurt 2014, Kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore dhe ndihmë për përkthimin në gjuhën angleze datë 07 maj 2014 dhe Njoftimin për ndërrim të adresës datë 14 shkurt 2019.

Me 07 gusht 2023 gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin përmes së cilit ndër të tjera kërkoi prova shtesë. Me 29 gusht 2023 përfaqësuesja e autorizuar e ankuesit avokate E Z përmes një parashtrere dorëzoi në gjykatë plotësimin e ankesës – prova shtesë si në vijim: Kopjen e letërnjoftimit në emër të bashkëshortes Xh M, Vërtetimin e lëshuar nga NSH “Goleshi” datë 12 dhjetor 2007, Kontratën e punës nr.04/2329 datë 30 dhjetor 2001 të lëshuar nga NSH “Goleshi” Magurë, Ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile nr. serik 20759885 në emër të bashkëshortes Xh M, Certifikatën e vdekjes të bashkëshortit (tani i ndjerë) nr. serik V.., Aktvendimin e lëshuar nga Komuna e Lipjanit – Drejtoria për administratë (Sektori i gjendjes civile) nr.2-203-31347 datë 16 qershor 2016, Formularin për parashtrimin e kërkesës jo-pronësore në likuidim (Dëshmia e kërkesës) e lëshuar nga AKP, nr.22978/2013 datë 07 nëntor 2013, Kontratën e punës të lëshuar nga NSH ”Goleshi” Magurë, nr.2/2329 datë 05 janar 2003 dhe Vendimin e kundërshtuar.

Me 28 shtator 2023, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile Kontestimore sipas të cilit ankuesi ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i sanksionuar edhe në nenin 23.2.3 dhe 23.2.4. të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 parashikon se “...*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: Kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”. Neni 608 i LPB i cili parashikon se “*pagesa e pagës apo rrogës, apo çdo lloj tjetër kërkesë e punëtorit që buron nga marrëdhënia e punës do të parashkruhet për tre vjet*”. Në vartësi të nenit më lartë, kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetësh nga koha kur NSH-ja pretendohet të mos ketë dështuar të përmbush obligimin e saj ndaj ankuesit i cili rrjedh nga marrëdhënia e punës, e që është tre vjet nga viti 2003 kur ankuesi pretendon që rrogat kanë mbetur të papaguara apo më së voni tre vjet nga dhjetori 2007 kur pretendohet borxhi i

njohur nga NSH. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur në kopje vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 11 dhjetor 2023 gjykata lëshoi përsëri një urdhër për përfaqësuesen e ankueses duke kërkuar nga e njëjta që të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të ankesës së saj, specifikisht Letër pezullimin apo Njoftimin për përfundimin e punësimit si dëshmi e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Me 29 dhjetor 2023 përfaqësuesja e ankuesit përmes një parashtrere e njoftoi gjykatën se i njëjti nuk ishte pajisur asnjëherë me një dokument të tillë. Në mbështetje të përgjigjes së saj (ri) dorëzoi në kopje dëshmitë si: Librezën e punës nr. serik 9758, Kontratën e punës me “NSH Goleshi” nr.2/2329 datë 05 janar 2003 Magurë dhe Vërtetimin e lëshuar nga NSH “Goleshi” datë 12 dhjetor 2007.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që:

“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit” .

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi (tani i ndjerë) ishte një punëtor i NSH “MIM Goleshi” Magurë. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja se a ka ofruar shërbime pune ankuesi dhe a i ka mbetur NSH borxh pagat për periudhën 2003 – 2006 . E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar, ndërsa ankuesi pretendon se kërkesa e tij është e ligjshme dhe e njëjta nuk është e parashkruar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij ndër të tjera e mbështet në: kontratat e tij të punës me NSH dhe atë kontratat nr. 04/2329 datë 30 dhjetor 2001 dhe nr. 2/2329 datë 05 janar 2003, që të dyja për vendin e punës punëtor në roje në Magurë, Librezën e tij të punës, Formularin e kërkesës të dorëzuar në procedurë të likuidimit nr. 229781/2013 datë 07 nëntor 2013, Vërtetimin e datës 12 dhjetor 2007, për të ardhurat personale të papaguara ndaj tij lëshuar nga NSH MIM “Goleshi” në Magurë për periudhën 2003 – 2006, librezën e punës, si dhe në pohimet e parashtruara në ankesë.

Nga kontratat e tij të punës me NSH me nr. 04/2329 datë 30 dhjetor 2001 dhe nr. 2/2329 datë 05 janar 2003, të dorëzuara si prova, vërtetohet fakti se ankuesi ishte në marrëdhënie pune në NSH MIM “Goleshi” deri me 30 qershor 2006.

Nga vërtetimi i datës 12 dhjetor 2007, lëshuar nga NSH MIM “Goleshi” në Magurë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte punuar tek NSH dhe se NSH-ja i kishte mbetur borxh atij shumë prej 1,446.00 € për periudhën 2003 – 2006, në emër të të ardhurave personale për punën e kryer.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara, kontratat e tij të punës me NSH me nr. 04/2329 datë 30 dhjetor 2001 dhe nr. 2/2329 datë 05 janar 2003, vërtetimi i datës 12 dhjetor 2007 dhe librezën e tij të punës, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për NSH për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSH i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se NSH nuk i ka mbetur borxh pagat, ashtu siç ka pretenduar ankuesi. Meqenëse e paditura nuk e ka kontestuar periudhën kohore të pagave të papaguara dhe as lartësinë apo shumën totale të pagave të papaguara të kërkuara nga ankuesi, si dhe nuk ka ofruar asnjë provë që do mund të rrëzonin pretendimet e ankuesit, gjykata e aprovon kërkesën e tij.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankuesit është parashkruar, nuk është i saktë. Ankuesi kishte dorëzuar një kërkesë brenda afateve tek AL me 07 nëntor 2013, kjo pasi NSH MIM “Goleshi” kishte hyr në procedurë të likuidimit me 23 shtator 2013. Gjykata vlerëson se, futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankuesit, kështu që ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund të atribuohet ankuesit

dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure.

Andaj, gjykata vie në përfundim se ankuesi kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe se NSH i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kështu i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-20-0508, AC-I-22-0123, AC-I-22-0228).

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 144.60 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e ankueses për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore për ankesën e parashtruar, për shkak të gjendjes së saj jo të mirë ekonomike.

E paditura është obliguar ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve, për ankesë në shumë prej 104.00 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar